



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr. 1230 Akti  
Datë 17.05.2016

Nr.1079 Vendimi  
Datë 24.06.2016



V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative Shkalla e Pare Vlorë, e përbërë nga:

**GJYQTARE: Gentiana XHELILI**

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 24.06.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr. 1230 Akti, që u përket palëve:

**PADITËS:** Asqeri Muhaj i biri i Mujo dhe Halime, i datelindjes 25.01.1962, lindur ne Belishove, Fier dhe banues ne lagjen "1 Maj", te Bashkise Fier dhe vendi i punes prane Prefektit te Qarkut Fier, identifikuar nga gjykata me identifikuar me pasaporten me Nr.BI49880136AL (ne mungese ne shpalljen e vendimit).

**I PADITUR:**1-Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuar ne gjykim me autorizimin me Nr.12312/1 prot,date 06.06.2016 nga Ervisa Shabani.  
2-Drejtoria e Pergjithshme Tatimeve, Drejtoria e Apelit Tatimor Tirane, përfaqësuar ne gjykim me autorizimin me Nr.18064/1 prot, date 03.06.2016 nga Ervisa Shabani.

Me pjesëmarrjen ne gjykim te Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë( ne mungese).

**OBJEKTI:**1-Kundershtimi e Vendimit me nr.5442/1 prot date 19.04.2016 te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorise se Hetimit Tatimor.  
2-Mospranimin e Njoftim Vleresimit per Detyrimin Tatimor ne shumen prej 30.000 (tridhjete mije) leke, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier.

**BAZA LIGJORE:** Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", Ligjin nr.9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të ndodhura në dosje, pala paditëse Asqeri Muhaj nuk u degjua ne

konkluzione perfundimtare pasi ishte ne mungese, ,dëgjoji palën pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor,prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane si dhe Drejtorine Rajonale Tatimore Fier,përfaqësuesen e tyre Ervisa Shabani e cila kërkoi nga gjykata rrëzimi e kërkesë padisë, pala pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk rezultoi të ketë paraqitur prapësime apo konkluzione perfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate ne lidhje me këtë gjykim, pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë dijeninë e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi;

### **V Ë R E N**

Se pala paditëse Asqeri Muhaj i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me një kërkesë padi me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze te nenit 12 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", gjykimi u zhvillua me trup gjykues te përberë nga një gjyqtar.

Gjykata kryesisht bazuar në nenin 125 dhe 193 të K.Pr.Civile ka endosur të thërrasë kryesisht përfaqësuesen e interesave të shtetit Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë.

### **Rrethanat e faktit:**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësi paditesi Asqeri Muhaj ka ushtruar aktivitet si person fizik ne profesionin e "Avokatit" me nr-K83301401L NUIS, me adrese ne lagjen "29 Nentori", Rruga "Dervish Hekali" Fier,i regjistruar prane Q.K.R ne date 01.09.2008.

Rezultoi se paditesi i eshte drejtuar me shkrese ne date 17.06.2014 pales se paditur Drejtorise Rajonale Tatimore Fier si dhe prane Q.K.R Fier ku ka kerkuar te çregjistrohet si subjekt tatimore qe ushtronte ne profesionin e "Avokatit".

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier pas verifikimit e te dhenave te sistemit informatik c@ts eshte konstatuar se subjekti tatimor Asqeri Muhaj per mos deklarimin e tatimit mbi te ardhurat nga punesimi (TAP), per periudhen Mars 2009-Qershor 2009 dhe Dhjetor 2009, i jane gjeneruar gjoba ne sistem ne shumen 30.000 (tridhete mije) leke.

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier eshte nxjerr "*Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore*" me nr.2927 date 04.02.2016, nepermjet te cilit paditesi detyrohet te paguante gjobat per deklarim te vonuar ne vleren 30.000 leke.

Paditesi pasi ka ardhur ne dijeni te "*Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore*" me nr.2927 date 04.02.2016 te nxjerr nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorisë se Apelit Tatimor pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane, e cila kjo e fundit me vendimin me nr.5442/1 prot date 19.04.2016 ka vendosur

"Lenien ne fuqi te aktit administrative, objekt-ankimi, Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.2927 prot date 04.02.2016, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, dhe rrezimin e ankimit".

**Paditësi Asqeri Muhaj** duke mos qene dakort me Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet Tatimore me nr.2927 prot date 04.02.2016 i lene ne fuqi me vendimin nr.5442/1 prot date 19.04.2016 nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane, i eshte drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;

**Së pari:** paditesi Asqeri Muhaj ka ushtruar aktivitet si person fizik ne profesionin e Avokatit me T.V.Sh.me adrese ne lagjen "29 Nentori", Rruga "Dervish Hekali" Fier.

Paditesi ka aplikur per mbyllje veprimtarise dhe per tu cregjistruar si person fizik i tatueshem ne date 17.06.2014 prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, duke i kerkuar ndjekjen e procedurave sa me shpejte per kalimin e kontrollit dhe konfirmimin sa me shpejt te mbylljes se aktivitetit, kerkese e cila eshte protokolluar me nr.9314 prot. date 17.06.2014.

Gjithashtu paditesi ka aplikur edhe ne QKR per te bere ç'regjistrimin si person fizik ne date 17.06.2014, ku deri ne date 10.12.2015 paditesi nuk ka pasur asnje koorespondence me Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, ne lidhje me kerkesen e mesiperm, per cregjistrim te personit fizike.

Por ne date 10.12.2015 me shkrese nr.25110 prot me lende "*Kerkese per informacion*", subjektit Asqeri Muhaj, i eshte kerkuar qe te dorezoje inventarin kontabel gjendjen 30.11.2015 i hartuar ne perputhje me standartet kombetare te kontabilitetit.

**Së dyti;** Ne date 28.12.2015 ne pergjigje te shkreses nr.25110 prot date 20.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier paditesi i ka sqaruar se ka bere kerkese per mbyllje te aktivitetit ne date 17.06.2014 dhe ne kete date ka aplikur edhe ne QKR per ç'regjistrim te personit fizike, e protokolluar ne Drejtorin Rajonale Tatimore Fier me nr.27074 prot. date 28.12.2015.

Gjithashtu ne date 28.12.2015 paditesi i ka bere kerkese Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, Drejtorise se Perpunitimit dhe Menaxhimit te ardhurave, qe te mbyll aktivitetin e tij nga data 17.06.2014, date ne te cilen ka paraqitur kerkesen per mbyllje te aktivitetit, e protokolluar me shkresen nr.27044 prot date 28.12.2015.

Ndersa Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtoria e Vleresimit e te ardhurave Tatimore dhe Kotabilitetit me shkresen nr.2927 prot. date 04.02.2016 me lende: "*Njoftim Vleresimi per Detyrimin Tatimor*", i njoftojne paditesit se per mos deklarim, Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi (TAP), per periudhen Mars 2009- Qershor 2009 dhe Dhjetor 2009, paditesi ka gjobe per deklarim te vonuar per tre tremujore ne shumen 30.000 (tridhjete mije) leke.

Ne date 16.02.2016, me ane te nje kerkese i drejtohet Drejtorise se Pergjithshme Tatimore Tirane, Drejtorise se Apelit Tatimor qe te me fal gjobat tatimore prej 30.000 (tridhjete mije) leke.

**Së treti;** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me ane shkreses nr.5692 prot. date 16. 03.2016, me lende: "*Njoftim dhe kerkese per pagese*", me njoftojne se tatim paguesi Asqeri Muhaj, me Nipt: K83301401B, me administrator Asqeri Muhaj, me adrese lagja "29 Netori", Rr."Dervish Hekali" Fier, me aktivitet Jurist, ku sipas te dhenave qe disponohen prane Drejtorise se Mbledhjes se Borxhit, rezulton se nuk ka paguar detyrimin e prezatuar

prane saj bazuar ne Njoftim-Vleresimi me nr.2927 prot date 04.02.2016, te gjebes prej 30.000 (tridhjete mije) leke, dhe nese ai nuk paguante vleren e plote te detyrimit tatimore, ndaj tij do te perdoren procedurat shternguese.

Ne date 22.04.2016 me poste i komunikohet Vendimi nr.5442/1 prot. date 19.04.2016 i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorise e Apelit Tatimor, ne te cilin kishte vendosur: "*Lenien ne fuqi te aktit administrative, objekt -ankimi, Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.2927 prot. date 04.02.2016, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, dhe rrezimin e ankimit*".

Duke ju referuar kesaj dispozite detyrim tatimor i papaguar paditesi pretendon se ka lindur ne vitin vitin 2009, ndersa Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.2927 prot date 04.02.2016, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, kerkohet te arketohet ne date 04.02.2016, pra ka kaluar afati pese vjeçar.

Paditesi ka qene i vetepunsuar dhe nuk ka pasur asnje person tjetër te punesuar dhe si i tille nuk ka qene subjekt per te deklaruar "Tatim mbi te Ardhura nga Punesimi" (TAP), por gabimish eshte futuruar si subjekt qe duhej te deklaronte "TAP".

Gjithashtu paditesi pretendon se kerkimi i pales se paditur eshte parashkruar, sipas nenit 100 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "*Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise*" i ndryshuar parashikohet se "*Parashkrimi i se drejtes per fillimin e procedurave per zbatimin e masave shternguese*".

E drejta per fillimin e procedurave per zbatimin e masave shternguese, sipas ketij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej te kryhej.

Afati i parashkrimit, parashikuar ne piken 1 te ketij neni, nderpritet gjate periudhes: *se ankimit i detyrimit tatimor; ose kur detyrimi tatimor eshte objekt i nje kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore.*

Për sa me sipër paditësi Asqeri Muhaj kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

**Palët e paditura, Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tiranë si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nëpërmjet përfaqësueses se tyre Ervisa Shabani e cila ka prapësuar ne këtë gjykim se;**

**Së pari;** rezulton se paditesi Person Fizik Asqeri Muhaj i biri i Mujos dhe i Halimes, i datelidnjes 25.01.1962, lindur ne Belishove, Fier dhe banues ne lagjen "1 Maj", te Bashkise Fier, person fizik "Asqeri Muhaj" i pajisur me NIPT K83301401L eshte nje tatimpagues i rregjistruar qe prej dates 01.09.2008 ne QKR.

Ne daten e regjistrimit ne QKR, pra ne daten 01.09.2008 paditesi eshte rregjistruar edhe me pergjegjesine tatimore TAP. Deklarata e pergjegjese tatimore Tap per periudhat tatimore Shtator/Dhjetor 2008 paditesi i ka bere brenda afateve ligjore te percaktuara, ndersa dekaratat e TAP-it per periudhat tatimore Mars/Qershor/Dhjetor 2009 paditesi i ka bere jashte afateve ligjore, konkretisht ne daten 04.06.2014 dhe per kete arsye automatikisht nga sistemi jane gjeneruar gjoba per deklarim te vonuar ne Shumen 10.000 leke per çdo deklarate te dorezuar me vonese.

Bazuar ne te dhenat e sistemit informatik c@ts Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka nxjerr aktin administrative "Njoftim Vleresimin per Detyrimet

Tatimore" me nr.2927 date 04.02.2016, nepernjet se cilit paditesit i komunikohen gjobat per deklarim te vonuar ne vleren 30.000 leke.

**Së dyti;** me "Njoftim Vleresimin Tatimor" me nr.2927 date 04.02.2016 tatimpaguesi "Asqeri Muhaj" nuk ka qene dakort dhe per kete arsye e ka ankimuar prane Drejtorise se Apelimit Tatimor, e cila ne perfundim te shqyrtim te ankimit administrative ka vendosur "Lenien ne fuqi te aktit administrative "Njoftim Vleresimin Tatimor" me nr.2927 date 04.02.2016 objekt ankimi, nxjerre nga DRT Fier".

Ky vendim i eshte komunikuar paditesit me shkresen me nr.5442 date 19.04.2016 me aktet administrative te sipercituar paditesi "Asqeri Muhaj" nuk ka qene dakort dhe per kete arsye i eshte drejtuar gjykates me padi me objekt "*Kundershtimin e Vendimit nr.5442/1 prot, date 19.04.2016 te DPT-se. 2. Mospranimin e "Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" ne Shumen 30.000 leke te DRT Fier*".

**Së treti;** Nga verifikimi i provave materiale te ndodhura prane Drejtorise rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vleresim nr.2927 date 04.02.2016 eshte ne perputhje me legjislacionit tatimor ne fuqi dhe nuk ka shkelje ligjore per shfuqizimin e tij.

Keshtu me Kodin e Procedurave Administrative ne nenin 118, percaktohen rastet se kur Aktet Administrative jane relativisht te pavlefshem: *Neni 118 Aktet administrative relativisht te pavlefshme; "1.Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershkim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme"*.

Ne referim te dispozites se sipercituar qe nje akt administrative te shfuqizohet duhet te kete dale ne kundershkim me ligjin, gje e cila nuk qendron ne rastin konkret. Keshtu referuar ligjit nr.9920/2008 "*Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise*" i ndryshuar ne nenin 6 percaktohet se kush quhet detyrim tatimor: *Neni 6 Detyrimi tatimor "3.Detyrimi tatimor perfshin tatimin, kamatevonesat, si dhe gjobat, per rastet e parashikuara nga ky ligj"*

Ndersa ne nenin 45 te tij percaktohet se tatipaguesit cregjistrohen pasi te paguaj te gjitha detyrimet tatimore dhe pas dorezimit te te gjitha deklarave tatimore: dhe konkretisht "*7. Personat e regjistruar ne organin tatimor mund te cregjistrohen ne rastet qe vijojne: a) personat fizike dhe juridike, sipas dispozitave te ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". 4.Subjektet e regjistruara prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ose gjykates gregjistrohen pasi te kene paguar te gjitha detyrimet tatimore te papaguara dhe pasi te kene paraqitur prane administrates tatimore, pasqyrat financiare dhe deklaratat tatimore per veprimtarine ekonomike te kryer nga data e mbylljes se periudhes se fundit tatimore dhe gjate procedures se likuidimit"*.

Ndersa ne nenin 64/65 te ligjit percaktohet detyrimi ligjor qe ka tatimpaguesi per te dorezuar deklaraten e plote dhe te sakte tatimore brenda afateve te percaktuara ligjore dhe deklarata quhet e doruzuar kur permbush kerkesat e ligjit:

Ne nenin 64 te ligjit parashikohet se *'1.Tatimpaguesi dorezon deklarate te plote dhe te sakte tatimore brenda afateve te percaktuara ne legjislacionin tatimor perkates'*.

Ne nenin 65 te ligjit percaktohet se *'5. Deklarata tatimore vleresohet e dorezuar, nese plotesohen kerkesat e ketij ligji, te legjislacionit tatimor dhe te akteve nenligjore, te dala ne zbatim te tyre'*.

Keshtu ne rastet kur tatimpaguesi nuk permbush detyrimet ligjore per dorzimin e deklarates tatimore brenda afateve te percaktuara ligjore penalizohet konform nenit 113 te ligjit *"Per Procedurat Tatimore"*, atehere penalizohet administrativisht sipas nenit 113 te ligjit *'Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise'* sipas te cilit *'Mosdeklarimi ne afat Tatimpaguesi, i cili nuk dorezon deklaraten tatimore ne afat, denohet me gjobe me 10.000 leke per cdo deklarate tatimore te padorezuar.*

Ne keto kushte duke qene se paditesi deklaratat e tap-it per vitin 2009 i ka cuar ne vitin 2014, sistemi informatik automatikisht ka llogaritur gjoba per deklarim te vonuar, ne vleren 10.000 per çdo deklarate te çuar me vonese.

Ndersa ne nenin 68 te ligjit percaktohet e drejta e administrates tatimore per nxjerrjen e Njoftim Vleresimit ne rastet kut detyrimi tatimor nuk paguhet ne kohe nga tatimpaguesi. *"Neni 68 Vleresimi tatimor*

*Vleresimi tatimor: a) eshte llogaritja e detyrimit tatimor te tatimpaguesit nga administrata tatimore; b) ne rastet kur shuma e detyrimit tatimor te vetedeklaruar nuk paguhet, eshte njoftimi, qe kerkon pagesen e detyrimit tatimor ne daten e percaktuar ne ligjin perkates.*

Nese tatimpaguesit i kerkohet te dorezoje deklarate tatimore dhe te paguaje detyrimin tatimor, deklarata merret si vetevleresim tatimor, ku pagesa e tatimit behet ne menyren dhe afatin e parashikuar ne ligjin tatimor perkates *"Ne lidhje me pretendimin se detyrimet e tij jane parashkruar, referuar legjislacionit tatimor, ku pretendim nuk qendron pasi ne nenin nr.73 te ligjit "Per Procedurat Tatimore", percaktohet se e drejta e administrates per nxjerrjen e Njoftim Vleresimit parashkruhet brenda 5 vitesh nga data e dorezimit te deklarates, ne çeshtjen objekt gjykimi dorezimi i deklaratave eshte bere ne qershor te vitit 2014, ndersa Njoftim Vleresim per keto deklarata te çuara me vonese ka dale ne shkurt te vitit 2016, pra jane brenda afatit 5 vjecare , pasi ne nenin 73 te ligjit parashikohet se 1.E drejta e administrates tatimore per te bere nje vleresim tatimor parashkruhet brenda 5 vjeteve nga data e fundit e dorezimit te deklarates tatimore, te percaktuar ne legjislacionin tatimor perkates. Ne keto rrethana, ata si pale e paditur argumentojne se nuk jane perpara afatit te parashkrimit.*

**Së katërti;** Gjithashtu edhe vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor nr.5442 date 19.04.2016 i cili ka lene ne fuqi Njoftim Vleresimi me nr.2927prot dt.04.02.2016 eshte ne perputhje me legjislacionin tatimore eshte tersisht i vlefshem dhe nuk ka baze ligjore dhe shkresore per shfuqizimin e tij.

Keshtu ankimim i subjektit "Asqeri Muhaj" eshte marre ne shqyrtim ne perputhje me nenin 106 pika 1, 2 dhe 3 si dhe nenin 107 pika 2 te Ligjit nr.9920. *"Per Procedurat Tatimore"*, keshtu ne ligj percaktohet neni 106 *"Objekti i ankimit administrativ tatimor"* parashikohet se *"1.Tatimpaguesi mund te ankimoje kunder çdo njoftim vleresimi, gdo vendimi qe ndikon ne*

detyrimin e tij tatimor, gdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor, ose gdo akti ekzekutiv teposagem tatimor, ne lidhje me tatimpaguesin. 2. Ankimi behet me shkrim dhe neformen e parashikuar ne zbatim te ketij ligji, me udhezim te Ministrit te Financave. 3. Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne drejtorine e apeimit tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur vleresimi ose vendimi i administrates tatimore eshte marre ose vleresohet tejete marre nga tatimpaguesi.

Neni 107 "Pasesa e detyrimit tatimor", objekt ankimimi ku parashikohet se ; 2.Shuma e pagueshme ose shuma e vene si garanci bankare, sipas pikes 1 te ketij neni, perjashton gjobat e perfshira ne vleresimi tatimor te ankimuar.

Ne keto kushte ne zbatim te neneve nr.106/107/108/109 te Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" dhe te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.24 dt.02.09,2008 te dale ne zbatim te tij, Drejtoria e Apeimit Tatimor merr vendim per Lenien ne Fuqi te Aktit Administrativ, Njoftim Vleresimi nr.2927prot dt.04.02.2016.

Keshtu ne nenin 108.3.a percaktohet se "Drejtoria e apeimit, pas shqyrtimit te ankimit, vendos: a) lenien ne fuqi te aktit, objekt ankimi dhe rrezimin e ankimit; "Ne keto rrethana Njoftim Vleresimi me nr.2927prot dt.04.02.2016 dhe vendimi i Drejtorise se Apeimit Tatimor nr.5442 date 19.04.2016 nuk jane akte te nxjerra ne kundershtrim me ligjin dhe nuk ka baze ligjore dhe shkresore per shfuqizimin e tyre.

**Për sa me sipër pala e paditur Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve Tirane si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier kërkoi nga gjykata rrezimin e kërkesë padisë si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.**

**Pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë,** nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungese me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk rezultoi që të ketë depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

**Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, administroi provat e paraqitura në gjykim çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditësi Asqeri Muhaj është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë do të rrezohet.**

#### **Arsyetimi ligjor:**

Në nenin 7, pika a të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për;

a)mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale,aktet nënligjore normative dhe kontrata administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga organi publik.

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Të drejtën e padisë e ka:

a)çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Ne nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e

*gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" parashikohet se ;Padia ngrihet;

*a)per shfuqizmin teresisht apo pjesisisht te aktit administrativ'*

Ne nenin 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se afati per ngritjen e padise dhe konkretisht

*Afati per ngritjen e padise:*

**'1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga:**

**a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;**

Rezulton se pala paditëse personi fizik Asqeri Muhaj nuk ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet Tatimore me nr.2927 prot, date 04.02.2016 nxjerrë nga pala e paditur, pasi akti administrativ është nxjerre ne zbatim te ligjit material.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga Ligji 'Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë', ligji nr.8438, date 28.12.1998 'Per tatimin mbi te ardhurat"i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Fillimisht gjykata analizon pretendimin e pales paditese nese jemi para nje akti administrativ te pavlefshem.

Ne nenin 118 te K.Pr.Administrative parashikohet se : *Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato ane nxjerre ne kundersiztim me ligjin por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshem.*

Rezulton qe akti administrativ njoftim-vleresimi per detyrimet tatimore me nr.2927, date 04.02.2016 është nxjerre ne zbatim te ligjit 'per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise' te ndryshuar dhe ligjit nr.8438, date 28.12.1998 'Per tatimin mbi te ardhurat '.

Ne nenin 13 te tij percaktohet se *'Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë. 2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.*

Ne nenin 13.1 parashikohet se "Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore. 2.Deklaruesi, në rast se konstaton gabime materiale të bëra nga ai vetë gjatë plotësimit të deklaratës, ka të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës, të bëjë korrigjimet e nevojshme. Brenda këtij afati, individi ka të drejtë të bëjë korrigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij

**korrigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 "Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim" të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."**

Ne nenin 64 të ligjit 'Per procedurat tatimore ne RSH' parashikohet se **'1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës.** 2. Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa prituri vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore. 3. Deklaratat dhe formularët e tjerë, që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen në dispozicion të publikut, pa pagesë, nëpërmjet: a) publikimit në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore; b) sporteleve të njëjësive të shërbimit për tatimpaguesin; c) dërgimit me postë, duke përdorur shërbimin postar rekomandë, për ata tatimpagues, që paraqesin kërkesë me shkrim për ofrimin e këtij shërbimi. 4. Formatet e deklaratave dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet deklaratës tatimore, miratohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Ne nenin 67 të ligjit parashikohet se "1. Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi. 2. Deklarata e ndryshuar mund dorëzohet brenda dymbëdhjetë muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare. 3. Dorëzimi i një deklaratë tatimore të ndryshuar përfshin: a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë; b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar; c) kërkesën e tatimpaguesit për kreditimin e tatimit të paguar më tepër plus interesat e llogaritura për këtë periudhë, duke e llogaritur këtë shumë për llogari të detyrimeve tatimore të tjera, ekzistuese apo të ardhshme; ç) kërkesën për rimbursimin e tatimit të paguar më tepër, plus interesat. 4. Për llogaritjen e interesit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji për kamatëvonesat.

Rezulton se në nenin 113 të ligjit parashikohet se **"1. Tatimpaguesi i cili nuk dorezon deklaratën tatimore në afat, denohet me gjobe me 10.000 leke për çdo deklaratë tatimor të padorezuar.**

Rezulton se pala paditese Asqeri Muhaj ka dorezuar me vonese deklaratat tatimore per muajt mars, qershor dhe dhjetor 2009 i ka dorezuar ne vitin 2014 dhe per kete arsye jane gjeneruar gjoba ne shumen prej 30000 leke ne total.

Pretendimi i pales paditese se eshte parashkruar e drejta per te filluar procedurat per zbatimin e masave shtrenguese ne zbatim te nenit 100 te ligjit 'Per procedurat tatimore ne RSH' eshte i pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Ne nenin 73 te ligjit 'Per procedurat tatimore ne RSH' parashikohet se 'e drejta e administrates tatimore per te bere nje vleresim tatimor parashkruhet brenda 5 vjeteve nga data e fundit e dorezimit te deklarates tatimore te percaktuar ne legjislacionin tatimor perkatese.

Rezulton se deklarata tatimore nuk eshte dorezuar ne vitin 2009 por eshte

dorezuar ne vitin 2014 dhe per kete arsye nuk eshte parashkruar e drejta e administrates tatimore per te kryer vleresimin tatimor per paditesin. Sa me siper, gjykata vendos rrezimin e kerkese-padise si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale ne shkallë vendi, shumen prej 30000 (tridhjetë mijë) lekë, dhe ne zbatim te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" kunder ketij vendimi nuk parashikohet ankim.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.Civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "***Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative***", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

1. Rrezimin e kërkesë padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
3. Kundër vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 24.06.2016

**SEKRETARE**

Edlira SHEHU

**GJYQTARE**

Gentiana ZHELILI

### **SHPENZIMET GJYQËSORE**

Taksa e padisë	3.000 (tre mijë) leke.
Njoftime	240 (dyqind e dyzet) leke.
<b>TOTALI</b>	<b>3.240 (tre mijë e dyqind e dyzet) leke.</b>